



1 Po ilitëbërojnë Sheshin e Flamurit , Rama i përgjigjet Bujar Leskaj! Fotorexhinjë u duket kolonata si stacion autobusësh! Projekti do i japë Vlorës një përmasë të re



2 Lufta/ SHBA do të furnizojë me tanke Ukrainën! Papa po mendon të vizitojë Kievin! Gendet i vdekur fotoreporterit ukrainas! Rusët mobilizojnë trupat në Transnistria të Moldavisë



3 E rrëndë/ Aksidenti ruqor i merr jetën 2 vëllezërve shqiptar në Itali, lanë pas 5 fëmijë (VIDEO)



4 E rrahu në fushatë elektorale, mori 'hak' sot? Mësohen të tjera detaje nga plagosja në Lezhë



5 Zgjedhja e presidentit të ri, Alibeaj i përgjigjet Berishës: Qëndrim personal, s ka lidhje me grupin parlamentar


U plagos një ditë më parë, arrestohet kreu i Njësisë Kallmet në Lezhë! Besnik Simoni dhe Altin Marku qëlluan 19 herë në drejtim të njëri-tjetrit! Një vit më parë u përplasën në fushatën elektorale

Mes kreut të njësisë administrative Kallmet dhe Altin Markut rezulton se ka pasur shkëmbin zjarri teksa të dy u plagosën një ditë më parë. Edhe zyrtari i pushtetit vendor ka qenë i armatosur ndërsa në vendngjarje u gjetën 19 gëzhoja. Zanafilla e konfliktit nis një vit më parë kur Altin Marku tentoi të prishte një takim elektorat të PS. Simoni dhe Marku akuzohen për veprat penale **"Vrasja me dashje"**, e mbetur në tentativë dhe **"Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve dhe municionit luftarak"**.

■ Pas konfliktit në zyrë, qëllohet me 3 plumba për shkak të detyrës kreu i Njësisë Kallmet në Lezhë! Arrestohet autori, edhe ai i plagosur



RAPORTO! Chat live me Shqiptaria.com



Elvis Hila

2 Prill, 09:00 | Përditësimi i fundit: 2 Prill, 11:48



Mes kreut të njësisë administrative Kallmet në Lezhë, Besnik Simonit dhe Altin Markut rezulton se ka pasur shkëmbin zjarri, teksa të dy u **plagosën** një ditë më parë. Bëhet me dije se edhe zyrtari i pushtetit vendor ka qenë i armatosur ndërsa në vendngjarje u gjetën 19 gëzhoja. Simonit iu komunikua sot masa e arrestit në Spitalin e Traumës, ndërsa policia nuk e ka gjetur ende armën me të cilën ai ka qëlluar në drejtim të Markut.

Report Tv mëson se zanafilla e konfliktit mes Simonit dhe Markut nis një vit më parë kur Altin Marku tentoi të prishte një takim elektorat të PS. Marku kishte tentuar të prishte një takim elektorat për zgjidhjet e 25-prillit, i cili ishte organizuar nga Besnik Simoni, që mban dhe postin e Kryetarit të Partisë Socialiste për Kallmetin. Në atë kohë ata janë përplasur verbalisht me njëri tjetrin dhe kjo çështje mes tyre nuk ishte mbyllur, duke sjellë përplasjen me armë mesditën e së premtes në rrugën që lidh Kallmetin me superstraden Lezhë-Shkodër.



LEXO EDHE: Aksidenti i trefishtë në aksin Lezhë-Milot (VIDEO)

Ngjarja u regjistrua rreth orës 13:00 të ditës së djeshme , ku Marku i bëri pritë në mes të rrugës funksionarit lokal, duke qëlluar disa herë brenda makinës me të cilën udhëtonte ai, ndërsa Simoni iu përgjigj po ashtu me të shtëna arme. Fatmirësisht nga përplasia me armë mes tyre nuk pati qytetarë të plagosur. Simoni mori tre plumba dhe ndodhet në Spitalin e Traumës në Tiranë, ndërsa Marku mori një plagë në krah dhe është dërguar po ashtu te Spitali i Traumës.

Marku u kap 4 orë pas ngjarjes, ndërsa ishte fshehur në banesën e një të afërmi të tij në fshatin Kallmet, ku policia gjeti edhe armën me të cilën ai plagosi Simonin.

Simoni dhe Marku akuzohen për veprat penale “Vrasja me dashje”, e mbetur në tentativë dhe “Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve dhe municionit luftarak”.

J.SH./r.k./Shqiptaria.com

TAG: [Lezhe](#) [Altin Marku](#) [besnik simoni](#)

Komento

Komente

Ana: 02/04/2022 15:42
Tipike sjellje shqiptare. Te zgjedhur vendor, qe jane kontigjente krimi qe rrine te armatosur e nuk pyesin per ligj. U duket vetja zoter e nuk duan t'ia dine per pasojat. Interesi tyre eshte te pasurohen sa me shpejt duke vjedhur e plaçkitur çdo gje qe u del perpara. Si puna e ketij jane 70% e te kryetareve te komunave, Njesive Administrative ne çdo cep te Albanistanit. Rrace neandertali...

Përgjigju

Te ju rrojn partia: 02/04/2022 14:22
Do vi rama e luli te bej burgun per ju . Turp ne 2022 te ngaterrohemi e vriteni e hyni ne hasmeri per parti politike

Përgjigju

Loni: 02/04/2022 09:35
Po nuk pasket pasur hic shenjester te dy... Shpejt ne poligon kur te dilni... Me nje plumb dy zogj pastaj...

Përgjigju

Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016



Sondazhi i ditës: A e rikthen dot Berisha PD-në në pushtet?

Po Jo Nuk e di

Lajme të tjera


Kronikë



Shpërthimi me lëndë plasëse jashtë një lokali dje në Lezhë, objektiv një 46-vjeçar! U largua pas ngjarjes, policia i vuri sot prangat! Autori në kërkim

2 Prill, 12:39

Sociale



Moti i keq, hapet qarkullimi në aksin Elbasan-Qafe Thanë! Masivi shkëmbor bllokoi rrugën Gjinar-Zavalinë, rënia e inerteve vështirëson kalimin në aksin Rrëshen-Kurbnesh

2 Prill, 10:39

Kronikë



Po transportonin lëndë narkotike në aksin rrugor Lezhë-Milot, dy të arrestuar

2 Prill, 08:31

Kronikë



Përshtati banesën për kultivimin e bimëve narkotike, arrestohet 47-vjeçari në Mamurras

2 Prill, 08:11

Kronikë



Pas konfliktit në zyrë, qëllohet me 3 plumba për shkak të detyrës kreu i Njësisë Kallmet në Lezhë! Arrestohet autori, edhe ai i plagosur! E paqartë nëse ka pasur shkëmbim zjarri (VIDEO)



Elvis Hila

1 Prill, 13:35

Kronikë



VIDEO/ Shpërthim me lëndë plasëse jashtë një lokali në Lezhë! Nuk ka të lënduar, vetëm dëme materiale

1 Prill, 13:02

Sociale



Moti i keq, bllokohet puna në Portin e Shëngjinit! Dallgët 7 deri në 8 ballë, pezullohet lundrimi në det! Orikumi dhe Radhima ende pa drita

1 Prill, 10:07

Kronikë



Era e fortë dhe deti me dallgë deri në 8 ballë, pezullohet lundrimi detar në portin e Shëngjinit

31 Mars, 17:39

Kronikë



4 familje bien pre e vjedhjeve në Lezhë, hajdutët u presin kokën bagëtive dhe i marrin

31 Mars, 10:58


Sociale



Pasditë poetike në Urën e Zogut, apel për ta mbrojtur: Është ndër 7 monumentet e rrezikuara të kulturës

30 Mars, 22:38

Sociale



Pelegrinazhi në Kishën e Shna Ndout, trafik i rënduar dhe kaos në lëvizje në rrugën e Laçit

29 Mars, 19:36

Kronikë



Lezhë, parking me koncesion në zonë arkeologjike?! Instituti: S'ka akt-marrëveshje

29 Mars, 12:05